



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr. 9
Prishtinë, më 30.1.2018, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, Aida Dërguti, Visar Ymeri, Dukagjin Gorani, Elmi Reçica, Evgjëni Thaçi-Dragusha, Sërxfan Mitroviq dhe Zafir Berisha.

Munguan: Time Kadrijaj, Danush Ademi dhe Doruntinë Maloku-Kastrati.

Në mbledhje ishte i pranishëm për raportim, Enver Hoxhaj, zëvendëskryeministër dhe Bashmir Xhemaj, bashkëpunëtor.

Pjesëmarrësit tjerë: Egesa Vitia, praktikante; Vlora Nushi, OPA/UNMIK; Naim Jakaj, këshilltar në Kuvend, Blerta Bejtullahu, EUSR/EU Office; Eugen Cakolli, KDI dhe media.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 26 dhjetor 2017 si dhe më 15 e 26 janar 2018;
3. Raportim i zëvendëskryeministrit Enver Hoxhaj;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Vjosa Osmani kryetare, konstatoi se Komisioni miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 26 dhjetor 2017 si dhe më 15 e 26 janar 2018;

Vjosa Osmani, kryetare, konstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 26 dhjetor 2017 dhe 15 janar 2018, ndërsa procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 26 janar 2018, bartet për shqyrtim në mbledhjen e radhës së komisionit.

3. Raportim i zëvendëskryeministrit Enver Hoxhaj;

Vjosa Osmani- Sadriu, njoftoi se zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj është ftuar në komisioni që të raportojë në lidhje me procesin e aplikimit të Republikës së Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës. Ajo kërkoi nga z. Hoxhaj të njoftohet se cila është strategjia dhe plani i veprimit për anëtarësim në KE, në mënyrë që të evitohen gabimet e bëra në proceset për organizatat e tjera, siç ishte rasti me UNESCO-në.

Osmani pyeti se cili do të jetë roli i Kuvendit dhe i Komisionit në veçanti për anëtarësim në KE, dhe si do të jetë koordinimi i Kuvendit me Qeverinë, në lidhje me këtë çështje. Ajo shprehu interesimin që komisioni të jetë i angazhuar në këtë proces, duke theksuar se duhet lobuar edhe në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

Enver Hoxhaj, zëvendëskryeministër, tha se krahas njohjeve të Kosovës, nuk ka prioritet më të rëndësishëm se sa anëtarësimi i Kosovës në organizatat e ndryshme ndërkombëtare. Sa i përket KE-së, z. Hoxhaj njoftoi se fillimisht Kosova është anëtarësuar në Bankën Zhvillimore të KE-së, pastaj edhe në Komisionin e Venecias. Një raport i ri i Kosovës me KE-në, tha se ka qenë krijimi i një raporti të ndërveprimit në mes të Kuvendit të Kosovës dhe Asamblesë Parlamentare të KE-së, ku edhe deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë qenë të pranishëm. Ajo se çfarë mund të ndodhë në vitin 2018, është dërgimi i aplikimit për anëtarësim në KE. Ai njoftoi se Shqipëria është bërë shtet anëtar i KE-së në vitin 1995, Maqedonia më 1995, Serbia më 2003-2005, Mali i Zi më 2007, por secilit vend i ka marrë kohë për afërsisht një deri në tri vite për t'u bërë shtet anëtar i KE-së. Nëse Kosova e dërgon aplikimin në vitin 2018 do të mund të anëtarësohet në KE në fund të vitit 2019 apo 2020.

Hoxhaj njoftoi se Danimarka e ka marrë kryesimin në nëntor të vitit të kaluar, është Kroacia e cila pason, pastaj Franca e Finlanda. Agjenda e KE-së tha se bëhet nga shteti i cili ka qenë ish kryesues i KE-së, në rastin konkret, Danimarka do të duhet të bashkëpunonte me Çekinë dhe nga një shtet i cili e merr në të ardhmen kryesimin e KE-së, këto tri vende vendosin nëse një vend do të hyjë në agjendën e aplikimit. Z. Hoxhaj bëri të ditur se Kosova i plotëson kriteret e brendshme në kuptimin e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së minoriteteve dhe se Kosova mund të bëhet anëtare e KE-së edhe për shkak të mbështetjes së madhe që do ta kishte prej shteteve anëtare, 34 nga 47 shtete anëtare të KE-së e kanë njohur Kosovën, tri deri katër vende të BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën kanë konfirmuar se do të votonin për anëtarësimin e Kosovës në KE. Këto vende edhe pse nuk e kanë njohur Kosovën kanë votuar edhe në të kaluarën për anëtarësimin e Kosovës në organizatat e ndryshme ndërkombëtare si EBRD, Banka Botërore, Komisionin e Venecias etj.

Hoxhaj tha se kundërshtar strategjik global i Kosovës është Rusia, e cila aktualisht është e suspenduar nga Asambleja Parlamentare e KE-së dhe mund të suspendohet edhe nga Këshilli i Ministrave dhe se kjo do të ishte një situatë shumë e favorshme për Kosovën. Ai njoftoi për benefitet e anëtarësimit të Kosovës në KE, siç është anëtarësimi i Kosovës në Procesin e Bolonjës, në Konventën Kulturore të KE-së dhe lidhur me rëndësinë e nënshkrimit të MSA-së etj.

Duhet të krijohet një grup punues, i cili përbëhet nga Presidenca, Kuvendi dhe Qeveria, që do të punojë për të përgatitur aplikimin dhe i cili do të marrë në përgjegjësi anëtarësimin e plotë të Kosovës në KE. Muaji shkurt mund të jetë koha e përshtatshme për të aplikuar për anëtarësim në KE dhe ka të bëjë me faktin se disa shtete të mëdha të KE-së e kanë konfirmuar mbështetjen e tyre, në drejtim të anëtarësimit të Kosovës në KE, tha Enver Hoxhaj.

Vjosa Osmani- Sadriu, pyeti zëvendëskryeministrin se sa do të ndikojë iniciativa për shfuqizimin e Gjykatës Speciale tek shtetet që kanë ndikim në KE; se a kanë bërë ndonjë hap mbrapa shtetet e fuqishme të KE-së, përderisa kjo iniciativë akoma mbetet në fuqi dhe se a duhet të pritët deri sa të merr epilog kjo çështje e pastaj të aplikohet për anëtarësim.

Osmani tha se Asambleja Parlamentare e KE-së në këtë proces do të duhet të jep një rekomandim për Komitetin e Ministrave dhe se këtu do të duhet të ketë një koordinim në mes të Qeverisë dhe

Kuvendit, pasi që nuk mjafton që t'i kemi vetëm dy deputetë të angazhuar në këtë proces, ndërsa në lidhje me Komitetin e Ministrave, tha se aty Kosova i ka 2/3 e votave, por si problem më të madh e sheh kalimin në AP dhe se kjo varet shumë nga angazhimi i Qeverisë, por edhe i Kuvendit.

Ajo pyeti z. Hoxhaj nëse është hartuar ndonjë strategji lidhur me aplikimin për anëtarësim dhe nëse kjo mund të ndahet me komisionin.

Aida Dërguti, tha se bashkëpunimi në mes të Kuvendit dhe Qeverisë duhet të koordinohet, pasi që bashkëpunimi në këtë fazë nuk ka qenë i mirë. Ajo njoftoi për përbërjen e delegacionit të Kuvendit të Kosovës në AP të KE-së. Znj. Dërguti tha se ndikimi i Ruisë është jashtëzakonisht i madh edhe pse nuk është prezent, dhe se duhet duke pas parasysh se Serbia është jashtëzakonisht aktive dhe shumë e afërt me vendet që ende s'ë kanë njohur Kosovën. Pengesa, tha se kanë pasur edhe në implementimin e një pikë të rezolutës për Kosovën që ka të bëjë me përcaktimin e ulëseve brenda AP-së dhe të drejtën e fjalës. Kjo tha se qenë e penguar nga Kryetari i AP-së, i cili ka qenë spanjoll dhe i cili ka qenë shumë i afërt me delegacionin e Serbisë.

Sa i përket angazhimit më të madh të Kuvendit, Dërguti tha se është shumë e rëndësishme përfshirja në grupet politike, sepse votimi në AP bëhet në baza të grupeve politike dhe e cilësoi të rëndësishme edhe shërbimin diplomatik të Kosovës dhe se diplomati që do të përfaqësojë Kosovën në Strasburg duhet të jetë diplomat i rryer dhe jurist me kualifikim.

Në lidhje me Bankën Zhvillimore të KE-së, Dërguti tha se Kosova edhe pse është anëtare nuk ka kërkuar mbështetje për ndonjë projekt dhe propozoi t'i sugjerohet Qeverisë që të kërkojë mbështetje për ndonjë projekt me interes për zhvillim ekonomik.

Enver Hoxhaj, duke u ndërlidhur me Gjykatën Speciale, tha se nëse raporti i Dick Marty-t është produkt i KE-së dhe nëse KE-ja nuk është e gatshme që ta ndihmojnë Kosovën që të paktën të pranohet aplikimi, kjo flet se për çfarë sistemi mund të ketë KE-ja. Pjesëmarrja e deputetëve të Kuvendit të Kosovës në AP duhet të jetë e një përbërjeje më të madhe, pasi që ka shumë delegacione të shteteve anëtare, të cilat duhet takuar.

Hoxhaj, po ashtu, foli edhe për bashkëpunimin dhe rolin e përfaqësuesve të Kuvendit të Shqipërisë në KE dhe tha se KPJ duhet të ketë një rol të plotë në mbështetjen e Kosovës në AP të KE-së. Është e vërtetë që kryetari i AP-së ka qenë spanjoll dhe ka qenë i dëmshëm, por tani kryetari është italian dhe se duhet të shikohen mundësitë se si t'i qasemi.

Ai njoftoi se Rusia ka ndikim të madh në KE, pasi që kontribuon me shuma të mëdha në buxhetin e KE-së, e po ashtu edhe dy vende të cilat janë mike të Kosovës kanë bërë një pagesë të mjaftueshme dhe mund të kenë rol më të madh në sigurimin e votave. Konsullata e Kosovës në Strasburg tha se duhet të ketë diplomatë dhe staf profesionalë.

Hoxhaj njoftoi se ka kërkuar nga ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale që të aplikojë për fonde në Bankën Zhvillimore të KE-së, pasi që kjo bankë merret më shumë me projekte të fushës së punës dhe mirëqenies sociale.

Vjosa Osmani- Sadriu, tha se procesi i anëtarësimit në KE do të dështojë nëse nuk ka angazhim të përbashkët dhe në qoftë se Kuvendi nuk është i përfshirë qysh nga fillimi në këtë proces. Me këtë rast ajo kërkoi që edhe komisioni të jetë i përfshirë në grupin e punës që do të formohet për këtë çështje.

Sa i përket nismës për shfuqizimin e Gjykatës Speciale, Osmani tha se ka mendim të kundërt me z. Hoxhaj, pasi që kjo nismë mund të krijojë përshtypjen se Kosova është kundër disa parimeve themelore për të cilat lufton KE-ja. Ajo tha se disa përfaqësues të shteteve, deputetëve u thonë se kjo nismë mund ta dëmtojë procesin e anëtarësimit të Kosovës në cilëndo organizatë ndërkombëtare, prandaj duhet pasur kujdes në përcaktimin e momentit të aplikimit në mënyrë që nisma për shfuqizimin e Gjykatës Speciale të mos ketë ndikim negativ.

Evgjeni Thaçi- Dragusha, duke iu referuar z. Hoxhaj, në lidhje me momentin e mundshëm të anëtarësimit në KE me 2019-2020, kur Gjeorgjia e mbanë kryesimin e AP të KE-së, propozoi formimin e një Grupi të Miqësisë me Gjeorgjinë dhe të gjendet momenti i duhur që të llobohet lidhur me anëtarësimin e Kosovës në KE.

Znj. Thaçi-Dragusha pyeti se cili është bashkëpunimi me shtetet fqinje, sidomos me Shqipërinë në lidhje me agjendën e Kosovës për anëtarësim në KE.

Zafir Berisha, foli për dështimin e anëtarësimit të Kosovës në UNESCO, ku shumë shtete mike kanë votuar kundër dhe se kjo krijon një situatë të re, ku Qeveria dhe Kuvendi duhet të kenë objektiva të qarta në periudhën afatshkurtër, duke i mobilizuar edhe grupet e miqësisë.

Berisha tha se me rastin e aplikimit duhet pas parasysh që disa vende mund të kenë zhvillime të brendshme politike, siç është rasti i Republikës Çeke. Këto zhvillime duhet të studiohen me kujdes dhe të mos pretendohet anëtarësimi në një organizatë, ku dështimi është i sigurt dhe shprehu mendimin se Kuvendi dhe ndikimi i deputetëve nuk duhet të lihen anash në këto zhvillime rreth anëtarësimit të Kosovës në KE.

Dukagjin Gorani, tha se çështja e anëtarësimit në KE nuk është çështje e politikës së jashtme, por është çështje e politikës së brendshme. Çështje e politikës së jashtme, tha se janë marrëdhëniet bilaterale të Kosovës me ndonjë shtet, mirëpo, çështja e anëtarësimit në organizata, sidomos çfarë është KE-ja, është barometër i situatës së brendshme në shoqëri.

Gorani pyeti se cilat janë pasojat që do t'i ketë Kosova nga KE-ja në kontekstin e anëtarësimit, nëse shfuqizohet Ligji për Gjykatën Speciale.

Enver Hoxhaj, tha se nuk e di se cili mund të jetë raporti i Kosovës me Gjykatën Speciale deri në kohën e anëtarësimit, duke vënë në pah se ka kontest të brendshëm për ta pranuar Kosovën. Z. Hoxhaj më tej shtoi se ka marr mbështetjen e shteteve që do ta udhëheqin KE-në për ta vendosur Kosovën në agjendë, për ta bërë shtet anëtar dhe se mund të humbet ky moment nëse nuk aplikohet në fillim të këtij viti.

Sa i përket grupeve të miqësisë, tha se diplomacia parlamentare mund ta ketë një rol më të madh përtej gjeografisë evropiane dhe se duhet formuar grupe të miqësisë me të gjitha vendet e mundshme duke përfshirë edhe shtetet që e kundërshtojnë Kosovën. Ai njoftoi se grupet politike si EPP, partitë socialiste dhe socialdemokrate, mund të dalin në mbështetje në bllok nëse deputetët e Kuvendit të Kosovës llobojnë brenda grupimeve të ndryshme politike.

Sa i përket koordinimit me Shqipërinë, tha se mbështetja e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë në KE duhet të trajtohet me ekskluzivitet.

Rreth dështimit të anëtarësimit të Kosovës në UNESCO, tha se është nxjerrë një bilanc nga ajo situatë. Sa i përket situatave të brendshme tek vendet e ndryshme, Hoxhaj tha se është një trend që vendet që e kanë njohur Kosovën po lëvizin drejt një njohje të butë, por ka vende që nuk e kanë njohur Kosovën dhe sillen sikur ta njihnin atë.

Vjosa Osmani- Sadriu, lidhur me çështjen e nismës për shfuqizimin e Ligjit për Gjykatën Speciale tha se brenda muajit do t'i jepet epilogu dhe do ishte më mirë që të pritej deri sa kjo çështje të përfundojë. Ajo kërkoi që të informohet komisioni, në lidhje me formimin e grupit punues nga Qeveria, në mënyrë që edhe komisioni të ketë një angazhim më aktiv, si dhe që komisionit t'i përcillet plani operativ nëse është hartuar.

Sa i përket beneficioneve me rastin e anëtarësimit të Kosovës në KE, tha se qytetarët e Republikës së Kosovës do të kenë të drejtë t'i adresohen Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe se kjo është arsyeja se pse Qeveria e Kosovës duhet ta ketë KE-në si prioritet në proceset e aplikimit. Znj. Osmani-Sadriu shtoi se anëtarësimi në KE është një proces që mund të marrë disa vite dhe hapi i parë duhet të bëhet gjatë këtij viti.

Aida Dërguti, mundësinë e lobimit për anëtarësim në KE e sheh përmes grupeve të miqësisë me shtetet relevante ngase aty përcillet mesazhi që të përkrahemi nga deputetët, të cilët janë pjesë të AP-së. Po ashtu, ajo tha se është i rëndësishëm anëtarësimi i subjekteve politike nëpër grupe politike, sepse mënyra e votimit shkon përmes grupeve politike ku merren edhe vendimet. Sa i përket votimit në AP, duhet të shihen qartë pozicionet e deputetëve, sepse vota e deputetit është autonome dhe nuk e merr gjithnjë qëndrimin në raport me qëndrimin e shtetit.

Elmi Reçica, tha se hapi i parë dhe vendimtar i Kosovës për të depërtuar drejtë mekanizmave ndërkombëtarë është anëtarësimi në KE. Ai theksoi se shumë shpejt do të realizohet edhe koordinimi në mes të Presidencës, Parlamentit dhe Qeverisë dhe se duhet të propozohen kriteret brenda të cilave do të jetë edhe komisioni.

Sa i përket grupeve të miqësisë, ato ende nuk janë funksionale dhe njoftoi se komisioni ka iniciuar plotësimin e grupeve të miqësisë, brenda të cilave ka vende që mund të ndikojnë fuqishëm në të gjitha këto procese.

Reçica njoftoi se Grupi i Miqësisë i Parlamentit Italian ka kërkuar të takohemi dhe se kjo është një mundësi e mirë për të lobuar tek ta, pasi që edhe Kryetari i AP-së është deputet italian. Është hendikep që raportues për Kosovën, përsëri do të jetë një deputet spanjoll dhe shtoi se do të duhej të krijohet një qasje dhe një ndikim për të na mbështesin.

Dukagjin Gorani, tha se nuk pajtohet me eskivimin e pyetjes nga zëvendëskryeministri dhe shtoi se duke e pas parasysh përvojën e z. Hoxhaj është e pamundur që ai të mos i dijë se cilat do të mund të ishin pasojat në rast të miratimit apo mosmiratimit të nismës për shfuqizimin e Gjykatës Speciale.

Ai pyeti Hoxhaj se çfarë udhëzimi iu kish dhënë deputetëve duke marrë parasysh që është profesionist i fushës dhe e njeh institucionin e KE-së, pasi që bëhet fjalë për një dokument i cili ka dalë nga ajo instancë dhe i cili ka shkakuar kundërtënie të madhe në shoqërinë. Gorani përsëriti pyetjen se cilat janë pasojat nëse shfuqizohet Gjykata Speciale.

Enver Hoxhaj, duke u ndërlidhur me pyetjen e deputetit Gorani, shprehu mendimin se kjo pyetje do të ishte relevante nëse do të ishte shtruar më 22 dhjetor, atëherë kur ka ndodh iniciativa. Ai tha se Gjykata Speciale po e merr epilogun e saj dhe se nuk është në pozitën e ministrit të jashtëm për të shpjeguar raportin e Kosovës me të gjitha shtetet që e kanë njohur dhe nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës. Ai shtoi se nëse këtë vit mendohet që të aplikohet në Interpol, mund ta ngrisim dilemën e njëjtë se pjesëmarrja e qytetarëve të Kosovës në konflikte të huaja mund të jetë e pafavorshme. Nëse në vitin 2019 është mundësia e radhës për të aplikuar në UNESCO dhe nëse në analizën tonë Kosova mund të bëhet anëtare e plotë në vitin 2020 në KE, ne tani duhet të aplikojmë për anëtarësim në KE.

Vjosa Osmani-Sadriu, tha se Komisioni për Punë të Jashtme, për shkak të rëndësisë që ka procesi i aplikimit në KE, po e shfrytëzon të drejtën për t'iu sugjeruar që pa marr epilog nisma për Gjykatën Speciale mos të dërgohet letra e aplikimit. Znj. Osmani-Sadriu shtoi se nëse pritet që kjo çështje të marr epilog atëherë do të ishte një situatë shumë më e favorshme për Republikën e Kosovës. Ajo shtoi se deri në muajin maj, kryesimin e KE-së e ka Danimarka, por edhe kur kryesimin e merr Kroacia, do të ishte moment i mirë për të aplikuar.

4. Të ndryshme.

Vjosa Osmani- Sadriu, kryetare, njoftoi se ministri i punëve të jashtme ka propozuar që të vijë më 31 janar 2018, të raportojë në komision, në lidhje me deklaratimet që i ka bërë në disa forume, në lidhje me çështjen e tërheqjes së njohjeve nga disa shtete, paralajmërimet nga shtetet tjera që mund ta bëjnë një gjë të tillë dhe për situatën e tanishme në shërbimin diplomatik.

Mbledhja përfundoi në orën 14:45

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja Komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu